



REPUBLIKA E SHQIPËRISË
BASHKIA DIBËR
SEKTORI I KUJDESIT SOCIAL

VENDIM NR 124 Datë 02.10.2020

“ Miratimin e Njësisë Lëvizëse për fëmijët me AK në Njësitë Administrative Fushë-Çidhën dhe Sllovë”.

Në mbështetje të ligjit nr.139/2015, “Për vetëqeverisjen vendore”, duke u mbështetur në ligjin nr. 9936 datë 26.06.2008 “Për menaxhimin e sistemit buxhetor në Republikën e Shqipërisë”, i ndryshuar dhe ligjit nr.88/2019 datë 18.02.2019 “Për zbatimin e buxhetit të vitit 2020”, i miratuar me vendimin e Këshillit Bashkiak Dibër nr.140 datë 26.12.2019, i konfirmuar nga Prefekti i Qarkut Dibër me vendimin , nr.16/1 prot. datë 17.01.2020, ku bashkia ka të drejtën e bashkëpunimit me institucione, organizata, individë dhe ka përparësi menaxhimin e projekteve, panaireve dhe aktiviteteve. Bashkisë, në mbledhjen e tij,
Projekti : “Tungjatjeta Jetë, Shërbim Lëvizës në familje, për Fëmijet me Aftësi të Kufizuara në Bashkinë Dibër”. Bashkia Dibër nëpërmjet Fondit Social, është një ndër 14 bashkitë përfitueset e para të financimit të qeverisë për 14 shërbime të reja që do të mbështesin 3500 njerëz në nevojë.Fondi Social është instrumenti i duhur financiar për ngritjen dhe zgjerimin e shërbimeve në territor. Me buxhetin e shtetit financohen bashkitë për ngritjen dhe zgjerimin e shërbimeve sociale për gratë, fëmijët në vështirësi, të moshuarit dhe të gjithë kategoritë në nevojë.

Investimet në infrastrukturë dhe rrugë janë të rëndësishme, por po aq të rëndësishme janë edhe këto shërbimet për grupet në nevojë në gjithë territorin e Bashkisë Dibër. Projekti synon që fëmijët me aftësi të kufizuara të zhvillojnë të gjithë potencialin e tyre si rezultat i mbështetjes psiko- sociale dhe terapive, të cilat u ofrohen në shtëpi nga një njësi profesionistësh lëvizëse.

Nevoja për këtë ndërhyrje është e identifikuar qartë në Planin Social të Bashkisë Dibër , përgatitur në 2018 nga Bashkia me mbështetjen e World Vision. Pas Qendrës Sociale për Fëmijët me AK në Peshkopi, Programit “Tungjatjeta Jetë ...” në Njësitë Administrative Maqellarë, Tomin dhe Kastriot vazhdojmë Shërbim Lëvizës për fëmijët me AK . Këshilli Bashkiak vendosi me datë 02.10.2020 me 16 vota pro 3 vota kundër 1 vota apstenim.

VENDOSI :

Njësinë Lëvizëse në Fushë-Çidhën dhe Sllovë. të përbërë nga 4 persona për periudhë 6-mujore:

2 Punonjës Social

1 Psikolog

Adresa: Bulevardi “ELEZ ISUPI”, Peshkopi, [email:bashkiadiber@gmail.com](mailto:bashkiadiber@gmail.com) nr.tel:0035521822935

1 Fizioterapist

III. Me zbatimin e këtij vendimi ngarkohet Sektori i Shërbimit Social, Sektori i Burimeve Njerzore dhe Sektori i Financës pranë Bashkisë Dibër.

IV. Ky vendim hyn në fuqi pas shprehjes për bazueshmëri ligjore nga institucioni i Prefektit të Qarkut Dibër

Kryetar Këshilli

Sokol SAVA

